



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Intervistë e Ministrit Sadri Ferati

25.03.2008

Decentralizimi, KE jep 14 milionë

Për vitin e parë të themelimit dhe funksionimit të tyre, dhe decentralizimin si proces, sipas MEF-it do të ketë një kosto prej 7 milionë e 100 mij euro. Në këtë kosto nuk janë paraparë investime të mëdha për komunat e reja. Për periudhën 2007-2010 KE-ja ka paraparë një buxhet prej 14.4 milion euro për mbështetje të zhvillimit të këtij procesi.

Kosova Sot: Z. Minister, sa ka arritur të identifikohet me punë ministria që kryesoni ju për këta muajt e parë të këtij mandati. Cilat kan qenë aktivitete dhe fokuset kryesore ku jeni përqëndruar si ministri për 100 ditët e para?

Ministri Sadri Ferati:Përveq një gjendje stabile të cilën e kam gjetur në ministrin e administrimit të pushtetit lokal që në fillim e kemi hartuar planin 100 ditor të punës dhe e kemi përfunduar së hartuari edhe planin e punës për këtë vit. Në kuadër të këtij plani si ministri i kemi identifikuar prioritetet e aktiviteteve të ministris dhe që në fillim e kemi përshpejtuar punën në hartimin dhe procedimin e ligjeve që dalin nga marrëveshja gjithpërfshirëse e Ahtisarit. Këto ligje kanë kaluar dhe janë votuar në Kuvend. Ka qenë një punë e ngutshme, por megjithate është bërë një punë e mirë në këtë drejtim. Tash jemi në procesin e ndërtimit të dokumentit veprues ose akcional, siq e quajm ne, të decentralizimit, si një pjesë e reformës së pushtetit lokal. Po e them kështu sepse siq dihet Kosova po kalon tash në një reformim të thellë të pushtetit lokal në përgjithësi. Ministria jonë, si bartëse e këtij procesi, është duke bërë çmos për ngritjen e kapaciteteve, por edhe të prodhoj dokumentet e nevojshme të cilat do të vihen në veprimin përkatës kur të vjen koha e duhur për zbatimin e tyre. Tash vetëm jemi në procesin përgaditor të zbatimit të Pakos së Ahtisarit dhe ende nuk kemi hyr në veprimin konkret. Shpresojmë që në momentin e krijimit të kushteve edhe ne do të jemi krejtë të gatshëm për procesin që na pret.

Kosova Sot: Si do të duket fillimi dhe si jeni duke u përgaditur për këtë proces?

Ministri Sadri Ferati:Në kuadër të atij plani veprues për decentralizimin ne i kemi hartuar dokumentet ndihmëse, siq është dokumenti për zhvillimin e një fushate që do të bëhet për

decentralizimin, dhe një formë tjetër e spjegimit të procesit të decentralizimit ngase decentralizimi si proces i ka dy segmente kryesore. Janë decentralizimi territorial dhe reforma e pushtetit lokal me të cilat parashihet edhe ridefinimi dhe shtrirja e disa kompetencave shtesë në kuadër të komunave por edhe ngritja e kapaciteteve për të pasur mundësi që reforma të zbatohet me sa më shumë sukses. Kjo ka për qëllim prodhimin e sa më shumë efekteve për ofrimin e shërbimeve sa më të mira për qytetarët edhe në fushën e shërbimeve komunale edhe të atyre publike.

Reforma e nisur

Kosova Sot: Veç përgaditjeve për një proces që pritet ku është fokusuar tash tash ministria juaj me prioritet e veçanta?

Ministri Sadri Ferati: Përveq ligjeve që kemi hartuar dhe atyre që janë në proces të hartimit, jemi edhe në proces të hartimit të dokumentit të implementimit të decentralizimit, siq e thash, e paraprakisht ministria veq e ka nënshkruar edhe një marrëveshje mirkuptimi për financimin e vetë objekteve për zyrat e vendit. Me krejtë këtë përgaditje veq fillon një decentralizim i shërbimeve në mënyrë që ato të fillojnë të afrohen sa më afër qytetarit. Kjo është prioritet bazë i ministris sonë së bashku me prioritetet tjera të këtij procesi. Mandej si pjesë e reformës si filluar gjithpërfshirëse jemi duke mbledhur edhe shenimet e duhura për digjitalizimin e shërbimeve në disa komuna. Disa prej komunave kanë ecur në këtë drejtim e disa kanë ngecur paksa prandaj jemi duke bërë një projekt të tërsishëm të analizes dhe të përshkruajmë nevojat për zhvillimin e një projekti komplet duke filluar nga 7 qendrat më të mëdha dhe duke u shtrirë ngadalë te secila komunë. Jemi duke punuar bashkarisht, edhe me asociacionin e komunave dhe kryetarët e komunave për hartimin e projektit i cili besojmë se do të realizohet edhe falë ndihmës së donatorëve të vullnetit të mirë që do të ndihmojnë në financim. Konsiderojmë se këtu është edhe ai fillimi i shërbimeve më efikase nëpër komuna. Pas finalizimit të këtyre dokumenteve do të fillojmë me hartimin e strategjis afatmesme të ministris që nënkupton si tërsi gjithë pushtetin lokal. Këtu bënë pjesë edhe korniza afatmesme e shpenzimeve e cila po përgaditet në kuadër të pakos për konferencën e donatorëve.

Kosova Sot: Përmendët funksionalizimin e zyrave të vendit. Në sa lokalitete do të hapen fillimisht zyra të tilla dhe a do të jenë këto një fillim në funksion të decentralizimit të disa shërbimeve komunale si pararendëse të procesit?

Ministri Sadri Ferati: Kjo më tepër ndërlidhet me dekoncentrimin e shërbimeve në mënyrë që ato të mos jenë të koncentruara së tepërmi në një objekt por duke u shpërndarë në disa prej këtyre zyrave ne do tu ofrohemi disa mjediseve, aty ku janë më të dendura, vetëm e vetëm që qytetarit ti afrohen sa më shumë shërbimet afër tij dhe të kryhen në mënyrë sa më kualitative. Përveq kompetencavë të tashmë që parashihen për komunat, me dokumentin gjithpërfshirës parashihen edhe kompetenca të tjera, disa të tilla, siq janë çështjet sociale, trafiku urban, ujësjellësit, skemat e ngrohjes, pastrimi dhe trajtimi i mbeturinave të ngurta, dhe të gjitha këto do të jenë kompetenca shtesë në sferën e shërbimeve publikë që shtohen në nivelet komunale.

Tri pilotkomuna kalojnë testin

Kosova Sot: Cili do të jeta fati i Pilot njësive komunale dhe a është bërë raporti analitik se si kane funksionuar këto në fazën e parë si test për të ecur përpara?

Ministri Sadri Ferati: Në bazë të vlerësimeve momentale që i kemi deri tash vlerësohet se që të tri pilot njësit e para, Hani i Elezit, Mamusha dhe Juniku kanë bërë progres të fuqis së vetorganizimit. Ne kemi vlerësuar se që të trija këto po e dëshmojnë veten se janë të afta të vëtoorganizohen në komuna të ardhëshme. Për këtë arsye edhe me ligjin për kufijt komunal këto tri komuna parshihet të avancohen nga pilot njësit në komuna normale. Pra si proces i decentralizimit në Kosovë do të kemi 8 komuna të reja. Prej tyre, siq dihet, 5 do të jenë me shumicë serbe kurse në këtë numër të ri komunash do të jenë dhe tri këto pilot njësit që I përmenda që do të shndërrohen në komuna të ardhëshme.

Pas ligjit, zgjedhje të reja

Kosova Sot: Praktikisht a mundë të na e thoni kohën se kur do të fillon ndërtimi dhe funksionimi i këtyre komunave të reja si pjesë e procesit të decentralizimit dhe cilla do të jetë kostoja e tyre buxhetore?

Ministri Sadri Ferati: Gjithsesi parashihet që ky proces të filloj me intenzitetin e tijë pasi të miratohet Kushtetuta dhe të hyn në fuqi. Pra do të jetë faza e tranzicionit, pastaj do të merret vendimi për shpalljen e zgjedhjeve, dhe njëkohësisht paralel me fillimin e fushatës dhe përgaditjen e zgjedhjeve do të bëhet edhe formimi i target grupeve, grupe të fokusuara të cilat do ta përgaditin komunën për ditën e zgjedhjeve dhe për strukturat që do të instalohen pas zgjedhjeve. Pra që nga momenti i përfundimit të zgjedhjeve do të instalohen komunat e reja dhe ato komuna do të fillojnë të punojn me ligjin e ri për qeverisjen lokale , me ligjin e ri për financat lokale dhe në këtë fazë do të dihet edhe numri i saktë i tyre. Për sa i përket koston buxhetore për vitin e parë të themelimit dhe funksionimit të tyre, dhe decentralizimin si proces, sipas MEF-it do të ketë një kosto prej 7 milionë e 100 mij euro. Në këtë kosto nuk janë paraparë investime të mëdha për komunat e reja. Ndryshe për periudhën 2007-2010 KE-ja ka paraparë një buxhet prej 14.4 milion euro për mbështetje të zhvillimit të ktij procesi.

Kosova Sot: Përmendët Ligjin për zgjedhjet lokale. Sa ka qenë e pranishme ministria juaj në hartimin e ligjit për zgjedhjet e reja lokale dhe kur do të miratohet ky ligj që është pjesë e pakos?

Ministri Sadri Ferati: Po. Edhe ne si ministri kemi qenë të inkuadruar dhe kemi dhënë kontribut në proces të hartimit të ktij ligji dhe ai draft është i përfunduar . Për shkak të prioriteteve që ka pasur fillimisht Ligji për qeverisjen lokale, Ligji për kufijt komunal dhe Ligji për financat lokale, procesi i Ligji për zgjedhjet lokale ka mbetur që edhe për disa elemente të punohet në të dhe besoj që mbrenda javës që vjen ky draft do të kalon edhe në nëngrupin për decentralizim që pastaj të shkon në procedurën e Qeveris dhe në parlament.

Kova Sot: Të ndalemi pak në situatën pas pavarësis. Si është duke funksionaur pushteti lokal në rrafshin e gjerë komunal dhe qfar janë raportet e komunikimit të ministris suaj me komunat me shumicë serbe?

Ministri Sadri Ferati: Siq dihet në komunat Leposaviq, Zubin Potok , Zveqan dhe Shtërpce, ata janë përcaktuar që tash të mos bashkpunojnë me ministrin e administrimit të pushtetit lokal dhe as me strukturat e UNMIK-ut. Ne në bashkëpunim me Ministrin e Punëve të Mbrendëshme kemi bërë zgjedhje shtesë që qytetarët e Firajës, dhe të rrëthinës së Shtërpces të mundë ti kryejnë shërbimet elementare. Ne presim që shpejtë edhe kjo situatë të tejkalohet dhe të filloj bashkëpunimi institucional, fillimisht për dobin e vetë atyre komunave. Është shumë i domosdoshëm edhe për ata vetë që të vendoset në binarët e duhur komunikimi i cili tash nuk ekziston.

Kosova Sot: A besoni që standardet e reformimit dhe decentralizimit në pushtetin lokal gjithsesi do ta përshpejtojnë shumë këtë proces?

Ministri Sadri Ferati: Po, edhe kam shumë arsëye. Këtë e them sepse ne e kemi kuptuar drejtë që duke e zhvilluar vetëveten, në aspektin e qeverisjes së mirë në interes për qytetarin, ne jo vetëm që iu shërbejmë interesave të qytetarëve por njëkohësisht krijojmë mundësi për përmbushjen e standardeve që janë të detyrueshme në drejtim të ecjes për integritet evropiane. Besoj që më përvojën e deritashme të krijuar nga institucionet e Kosovës edhe vetëdijsimi i qytetarëve, edhe për nivelin komunal, në përkushtimin që e kemi të gjithë së bashku, komunat do të ecin me sukses dhe këto standarde nuk do të jenë pengesë e ecjes së sukseshme të Kosovë në integritet evropiane.

Fushata

Qëllimi i fushatës është që ti informojmë sa më drejtë qytetarët se çka është decentralizimi dhe çka do të përfshij ai. Qytetarët duhet ta kuptojnë gjithsesi se së shpejti komuna do të jetë ajo që do të fuqizohet dhe do të kujdeset për qytetarët, për një numër shërbimesh kualitative që nuk i ka ofruar deri tash. Qëllimi tjetër është që tu bëjmë me dije qytetarëve se neve na duhet një angazhim i veçantë që në kuadër të ngritjes së kapaciteteve të qeverisjes lokale në Kosovë komunat kanë rëndësi të madhe më të cilën pastaj do të maten edhe standardet ndërkombëtare drejtë ecjes me sukses për integrimet evropiane. Kjo është krejtë ajo e veqanta dhe domosdoja e kuptimit të rëndësisë së këtij procesi. Decentralizimi dhe funksionalizimi i pushteteve lokale drejtpërdrejtë është përmbushje e standardeve, një pjesë të madhe të tyre, që janë standarde për integrim.

Intervistoi: Sylë AHMETI